

V E N D I M
Nr.431, datë 25.3.1996

**PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS E TË PUSHIMIT NË NDËRMARRJET E
KONSERVAVE, KOPSHTARISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në ndërmarrjet e prodhimit të konservave puna e ditës, për periudhën nga 15 maj deri në fund të tetorit nuk mund të fillojë para orës 500 dhe as të zgjatë pas orës 2200. Për pjesën tjetër të vitit puna nuk mund të fillojë para orës 600 dhe as të zgjatë pas orës 2000.

Numri i orëve shtesë nuk mund të kapërcejë 2 orë në ditë dhe as 220 orë në vit për çdo punëmarrës. Këto limite mund të kapërcehen, kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të mënjeluar dëmtimin e mallit.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën për ata punëmarrës që janë dakord dhe vetëm kur kjo gjë është e domosdoshme për të mënjeluar dëmtimin e mallit. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 50 përqind. Kohëzgjatja e punës së natës nuk duhet të kapërcejë 8 orë në ditë për çdo punëtor dhe ajo duhet të përfshihet në një interval kohor prej 12 orësh.

2. Në kantinat dhe punishtet e prodhimit të verës e të rakisë kohëzgjatja maksimale javore e punës është 72 orë gjatë 8 javëve të periudhës së vjeljeve dhe 50 orë pjesën tjetër të vitit.

Numri i orëve shtesë nuk mund t'i kapërcejë 2 orët dhe për çdo punëmarrës, me përjashtim të rasteve të rralla, ose gjatë periudhës 8-javore të vjeljeve, gjithmonë duke respektuar kufirin prej 120 orësh në vit. Përtej këtij kufiri duhet kërkuar një leje e posaçme nga Inspektorati i Punës. Punëmarrësit duhet të kenë një pushim ditor prej 10-orësh pa ndërprerje.

Gjatë periudhës së vjeljeve prej 8-javësh punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën dhe të dielave. Punëmarrësi duhet të ketë të paktën një të dielë pushim në 4 javë.

3. Në ndërmarrjet e kopshtarisë kohëzgjatja maksimale javore e punës është 51 orë. Ajo mund të zgjatë maksimumi 4 orë gjatë 16 javëve në vit, me kusht që mesatarja vjetore të mbetet 51 orë.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë punën të dielave; kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të parandaluar dëmtimin e pemëve. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 50 përqind. Puna të dielën mund të urdhërohet edhe për të siguruar një shërbim ruajtjeje. Ky shërbim duhet të kufizohet në atë që është më e domosdoshme. Një punëmarrës nuk mund të caktohet në këtë shërbim më shumë se një herë në një periudhë prej 4 javësh, me përjashtim të rasteve shumë të rralla. Punëmarrësi duhet të ketë të paktën një të dielë pushim në 3 javë.

4. Në ndërmarrjet e pyjeve dhe të kullotave punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 25 përqind.

5. Në gjithë sektorët e mësipërm puna duhet të ndërpritet nga pushime minimumi:

15 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta.

30 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë, dhe

60 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi